1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më

vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 1: RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE E ASHENSORËVE TË SPITALIT KORÇË

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Vendi i kryerjes së punimeve: Shërbimet do të kryhen në

- a) Ashensori i Poliklinikës Qëndrore Tip IGV
- b) Ashensori i Maternitetit Tip BIOFAL
- c) Ashensori i Pediatrikës Tip KLEEMANN
- d) Ashensori i Urgjencës Spitalore Tip STAR
- e) Ashensori patologji Tip KLEEMANN

Të dhënat/specifikimet teknike të ashensorëve që ka Spitali Korçë:

- a) **Ashensori i Poliklinikës Qëndrore Tip IGV**
Nr 1052.
Ngarkesa e lejuar e punës 450 kg
Numri i niveleve të ndalimit 3

Shpejtësia e lejuar 0.63 m/s

b) Ashensori i Maternitetit Tip BIOFAL

Nr 57551.

Ngarkesa e lejuar e punës 1300 kg

Numri i niveleve të ndalimit 4

Shpejtësia e lejuar 0.63 m/s

c) Ashensori i Pediatriisë Tip KLEEMANN

Nr 44710.

Ngarkesa e lejuar e punës 1500 kg

Numri i niveleve të ndalimit 5

Shpejtësia e lejuar 0.63 m/s

d) Ashensori i Urgjencës Spitalore Tip STAR

Nr 63750-A.

Ngarkesa e lejuar e punës 1500 kg

Numri i niveleve të ndalimit 3

Shpejtësia e lejuar 0.63 m/s

e) Ashensori Patologji Tip KLEEMANN

Nr 94082.

Data e prodhimit viti 2006.

Ngarkesa e lejuar e punës 1300 kg

Numri i niveleve të ndalimit 3

Shpejtësia e lejuar 0.63 m/s

PËRMBAJTJA

Përshkrimi i punimeve që do të kryhen në objektet e sipërpërmendura.

SEKSION 1. Zërat e punimeve

2.12 F.v. vajnica dhe vaj per shinat

2.13 F.v. graso në nyjet lëvizëse

2.14 F.V. vaj hidraulik 46

2.15 F.v. llampa 100 W për ndriçimin e pusit

2.16 F.v. çelsa te dyreve te kateve

2.17 F.v. çelsa avarie te kabines

2.18 F.v. butona te thirrjes se kateve

2.19 F.V. Mekanizëm dere mekanike

2.20 F.v. rripa transmisioni të dyerve

2.21 F.v. llampa kabine per ndriçim 100wat

2.22 F.V. sensorë manjetik (no-nc)

2.23 F.V. Guarnicion pistonit Ø 100-200 mm

2.24 F.v. automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220 V, 63A

2.25 F.v. automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P, Id=0,03A

2.26 F.V. Rrëshkitëse kabine 8-16 mm

2.27 Butona tregues te dyreve te jashtme

2.28 Butoneri e brendeshme

-
- 2.29 F.v kabëll fleksibël ashensori
 - 2.30 F.v kavo çeliku Ø 12 ashensoret
 - 2.31 F.v. patina portash
 - 2.32 F.v. rula për hapje dhe mbyllje dere
 - 2.33 Kuzhineta pulexhi hid
 - 2.34 F.v. inverter dyersh
 - 2.35 F.v. pult komandimi
 - 2.36 F.v. lëshues 63A
 - 2.37 F.v. operator kabine
 - 2.38 F.v motor mekanik kabine (24V DC)
 - 2.39 F.v.fotocelule (12 V DC)
 - 2.40 F.v.akses karte
 - 2.41 F.v kontaktet e dyerve te jashteme
 - 2.42 F.v Display
 - 2.43 F.v Panel kontrolli 22 kw hidrualik
 - 2.44 F.v Emergjence e kompletuar per ashensor hidrualik
 - 2.45 F.v bateri emergjence 12 v 7 a/h

SEKSION 2. Specifikimet e zërave të punimeve

- 12. *F.v. vajnica dhe vaj per shinat*
Depozita vaji për vetëvaisjene shinave dhe vaj
- 13. *F.v. graso në nyjet lëvizëse*
Graso në nyjet lëvizëse
- 14. *F.V. vaj hidraulik 46*
Vaj ISO 46 për sistemet hidraulike
- 15. *F.v. llampa 100 W për ndriçimin e pusit*
Llampa 100 W 220 volt për ndriçimin e pusit
- 16. *F.v. çelsa te dyreve te kateve*
Çelësa për qarkun e sigurisë të dyerve të kateve
- 17. *F.v. çelsa avarie te kabines*
Çelësa për qarkun e sigurisë avarie të kabinës
- 18. *F.v. butona te thirrjes se kateve*
Butona të thirrjes së kateve nga jashtë 12 – 24 VDC
- 19. *F.V. Mekanizëm dere mekanike*
Mekanizëm dere për dyert e jashtme 900mm – 1300 mm
- 20. *F.v. rripa transmisioni të dyerve*
Rripa transmisioni të dyerve 5mm x 12mm
- 21. *F.v. llampa kabine per ndriçim 100wat*
llampa kabine për ndriçim 100wat 220 volt
- 22. *F.V. sensorë manjetik (no-nc)*
Sensorë manjetik (impulsorë no-nc)
- 23. *F.V. Guarnicion pistoni Ø 100-200 mm*
Guarnicion pistoni Ø 100-200 mm

-
24. *F.v. automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220 V, 63A*
Automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220 V, 63A
25. *F.v. automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P, Id=0,03A*
Automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P, Id=0,03A
26. *F.V. Rrëshkitëse kabine 8-16 mm*
Rrëshkitëse kabine për shinë 8-16 mm
27. *Butona tregues te dyreve te jashtme*
Butona tregues te dyreve te jashtme (Display - ekran)
28. *Butoneri e brendeshme*
Butoneri e brendeshme 1 – 6 kate
29. *F.v kabëll fleksibël ashensori*
kabëll fleksibël ashensori 24 x 0.75 mm
30. *F.v kavo çeliku Ø 12 ashensoret*
Kavo çeliku Ø 12 ashensoret
31. *F.v. patina portash*
Patina portash (rrëshkitese të kanatave të portave)
32. *F.v. rula për hapje dhe mbyllje dere*
Rula për hapje dhe mbyllje dere (fermator – telco- geman)
33. *Kuzhineta pulexhi hid*
Kuzhineta pulexhi hid (pulexhi i pistonit)
34. *F.v. inverter dyersh*
Inverter dyersh (fermator – telco- geman)
35. *F.v. pult komandimi*
Pult komandimi (pult i cili përdoret për servisin – mirëmbajtjen)
36. *F.v. lëshues 63A*
Lëshues 63A 4p 24 – 220 VDC
37. *F.v. operator kabine*
Operator kabine 800 – 1300 mm
38. *F.v motor mekanik kabine (24V DC)*
Motor mekanik kabine (24V DC)
39. *F.v.fotocelule (12 V DC)*
Fotocelule (sensor dere 12V DC)
40. *F.v.akses karte*
Akses Karte (çipa aksesi)
41. *F.v kontaktet e dyerve te jashteme*
Kontaktet e dyerve te jashteme 48 – 110 AC
42. *F.v Display*
Display (ekran që tregon numurat në kabinë 7 segmente)
43. *F.v Panel kontrolli 22 kw hidrualik*
Panel kontrolli 22 kw hidrualik 380volt
44. *F.v Emergjence e kompletuar per ashensor hidrualik*
Emergjence e kompletuar per ashensor hidrualik
45. *F.v bateri emergjence 12 v 7 a/h*
Bateri emergjence 12 v 7 a/h

Shënim: AK gëzon të drejtën të përjashtojë nga mirëmbajtja, një apo disa pajisje objekt shërbimi në këtë procedure prokurimi, në rast se pajisja del end-of-support, dhe OE do ta pranojë pa pasoja për AK.

Kontratat do të jepen brenda periudhës, nga momenti i lidhjes së MK me OE, me afat përfundimtar 24 muaj nga lidhja e MK.

Kontratat do të lidhen, me kërkesën e Sektorit Teknik, bazuar në periudhën e mbulimit të shërbimit, brenda periudhës së Marrëveshjes Kuadër.

** Pajisjet/agregatet/materialiet që do të përdoren për furnizim vendosje duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike/ose ekuivalente.*

Nr.	Njësia	Termet e references/Specifikimet teknike
Nr.	Përshkrimi i riparim-shërbimeve mirëmbajtëse	
1	Gabina dhe veshja e brëndshme e gabinës dhe kontrolli i përmasave. Pajisjet dhe kontrolli i mbylljes mekanike + elektrike të dyerve në sheshpushim dhe në gabinë.Kontroll i çelësave fundorë. Kontroll i pajisjes bllokuese të derës dhe çelësi i tij.Ndriçimi i kabinës. Ndriçimi emergjent. Mirëmbajtja e komponentëve të instalimit elektrik. Gjëndja e dyshemesë . Butonat dhe llampat e prenotimit. Butonat hapje+mbyllje porte. Çelësat e sigurisë.	Kërkesat teknike për kontrollin, verifikimin dhe mirëmbajtjen periodike të komponentëve të kabinës, dyerve, sistemit elektrik dhe pajisjeve të sigurisë së ashensorit, me qëllim garantimin e funksionimit të sigurt dhe në përputhje me standardet
2	Gjëndja e tavanit të kabinës.. Kontroll, pastrim, rregjistikim operatori. Kontakti i parashutës. Vajisje e shinave të kabinës . Gominat e fiksimit kabinë-arkade. Kontroll tokëzimi kavo, kabinë arkade. Gjëndjen e fijeve fleksibël.	Kontrollet përfshijnë verifikimin e rregullt të: - Gjendjes së kabinës (veshje, tavan, dysheme, ndriçim normal dhe emergjent). - Funksionimit mekanik dhe elektrik të dyerve dhe pajisjeve bllokuese. - Çelësave fundorë, kontaktit të parashutës dhe qarkut të sigurisë. - Instalimit elektrik, tokëzimit dhe fijeve fleksibël. - Vajisjes së shinave dhe kontrollit të elementëve amortizues kabinë-arkadë. - Panelit të komandimit, butonave dhe sinjalizimit.
3	Pastrimi dhe ndriçimi i sallës .valvolës së rënies. Kontroll pajisjes për parandalimin e lëvizjes së pakontrolluar të kabinës gjatë lëvizjes. Kontroll i pajisjes për sigurimin se ashensori nuk funksionon nëse dyert në sheshpushim janë të hapura. Kontroll pajisjeve për kufizimin e mbishpejtësisë. Kontroll kavot metalike dhe kavo tërheqëse. Kontroll funksionimit të automatëve. Kontroll i agregatit ngritës. Kontroll gjëndjes kavos së rregullatorit. Kontroll i kavove metalike, ,	Kontrollet periodike përfshijnë: - Pastrimin dhe verifikimin e ndriçimit të sallës së makinerisë. - Kontrollin e valvolës së rënies dhe funksionimit korrekt të saj. - Kontrollin e pajisjes për parandalimin e lëvizjes së pakontrolluar të kabinës (UCMP). - Verifikimin që ashensori nuk funksionon nëse dyert e sheshpushimit janë të hapura.

		• Kontrollin e pajisjeve për kufizimin e mbishpejtësisë (rregullatori i shpejtësisë). • Kontrollin e kavove metalike dhe kavove tërheqëse (konsumim, tensionim, fiks). • Kontrollin e funksionimit të automatëve dhe mbrojtjeve elektrike. • Kontrollin e agregatit ngritës (motor, reduktor, kushineta). • Kontrollin e gjendjes së kavos së rregullatorit.
4	Kontroll i nivelin e vajit në reduktor. Kontroll i ventilatorit ftohës .Pastrimi i elektromotor, reduktor . Kontroll për xhoko vidë-koronë, pastrimi i tembuos së kontroll pulexhos el/motorit dhe devijimet , fortësisë së sustës së frenit. Kontroll gjëndjen e ferrotave të frenit.	Kontrollet periodike përfshijnë: • Verifikimin e nivelit dhe cilësisë së vajit në reduktor. • Kontrollin e funksionimit të ventilatorit ftohës të motorit. • Pastrimin e elektromotorit dhe reduktorit nga pluhurat dhe papastërtitë. • Kontrollin e xhokos vidë-koronë për konsumim ose zhurma jonormale. • Pastrimin e tembuos dhe kontrollin e pulexhos së elektromotorit për devijime ose konsumim. • Verifikimin e fortësisë dhe rregullimit të sustës së frenit. • Kontrollin e gjendjes së ferrotave të frenit (trashësi, konsumim, fiks).
5	Pastrimi, shtrëngimi i stafave të shinave. Pastrimi, shtrëngimi i dyerve të katit. Kontroll i stafave të petashuqeve. Ndriçimi i kafazit. Tokëzimi i shinave udhëzuese.	Kontrollet periodike përfshijnë: • Pastrimin dhe shtrëngimin e stafave (kapëseve) të shinave udhëzuese. • Pastrimin dhe shtrëngimin e dyerve të katit dhe elementëve të fiksimit. • Kontrollin e stafave të (petashuqeve) për fiksime dhe deformime. • Verifikimin e funksionimit të ndriçimit të kafazit (boshtit të ashensorit). • Kontrollin e tokëzimit të shinave udhëzuese dhe vazhdimësisë së lidhjes me tokën.
6	Kontroll zhurme lëshues, rele etj. Shtrëngim fije tek lëshuesit dhe relet . Provë + regjistrim termikun e thithjes Kontroll tokëzimit të kuadrit. Kontroll përfaqimi i morsetave tek skeda. Pastrim skede, kontroll transformatori.	Kontrollet periodike përfshijnë: • Kontrollin e zhurmave jonormale në lëshues, rele dhe kontaktorë. • Shtrëngimin e fijeve/klemave në lëshues dhe rele. • Provë funksionale dhe regjistrim të termikut të thithjes (mbrojtja termike). • Kontrollin e tokëzimit të kuadrit elektrik. • Verifikimin e përfaqimit (shtrëngimit) të morsetave në skedë.

		• Pastrimin e skedës elektrike nga pluhurat dhe oksidimet. • Kontrollin e transformatorit (fiksime, tension dalje, mbinxehje).
7	Kontrolli i dado-tirantëve, morsetave të kavos dhe rregullatorit. Shtrëngimi i bulonave të arkadës. Kontrolli i xhokos (hapesirave) dhe guarnicioneve. Gjendja e tirantit, prova e parashutës. Kontrolli i arkadës, k/peshës dhe kavot. Vërejtje: shina, kabinë+kundërpesha. Gjendja fizike në tërësi	Kontrollet periodike përfshijnë: • Kontrollin dhe shtrëngimin e dado-tirantëve dhe morsetave të kavos mbajtëse. • Kontrollin e morsetave të kavos së rregullatorit të shpejtësisë. • Shtrëngimin e bulonave të arkadës (kornizës mbajtëse). • Kontrollin e xhokos (hapesirave) dhe gjendjes së guarnicioneve. • Verifikimin e gjendjes së tirantëve dhe kryerjen e provës së parashutës sipas procedurës teknike. • Kontrollin e arkadës, kundërpesës dhe kavos për konsumim, tensionim dhe fiksime korrekte. • Vërejtjen e shinave të kabinës dhe të kundërpesës sipas specifikave teknike. Vlerësimi i gjendjes fizike në tërësi të sistemit mekanik.
8	Kontrolli, pastrimi i gropës. Kontrolli i deviatorit dhe prizës. Kontrolli i gjendjes së sustës+zinxhirit. Kontrolli i distancës kabinë-k/peshë-susta. Kontrolli i kontaktit të kavos së rregullatorit. Kontrolli i gjendjes së pulexhos të tendikavos. Kontrolli i zgjatjes së kavos rregullatorit. Kontrolli i bazamentit, korodimit të shinave	Kontrollet periodike përfshijnë: • Pastrimin dhe kontrollin e gjendjes së gropës së ashensorit. • Kontrollin e deviatorit dhe prizës për fiksime dhe funksionim korrekt. • Kontrollin e sustës dhe zinxhirit (konsumim, lubrifikim, fiksime). • Kontrollin e distancës kabinë–kundërpeshe–sustë. • Kontrollin e kontaktit të kavos së rregullatorit. • Kontrollin e gjendjes së pulexhos dhe tendikavos (fije fleksibël). • Kontrollin e zgjatjes dhe tensionit të kavos së rregullatorit. Kontrolli i bazamentit dhe gjendjes së shinave për korrozion ose deformime.
9	Kontrolli i mbylljes mekanike të dyerve. Kontakti elektrik, çelësi i emergjencës, pastrimi i kasës sipër dhe i karelit. Kontrolli i regjistrimit të hapësirës së ulave. Kontrolli për konsumim, shtrëngim të patinave rulat të akopjimit. Provë. Kontrolli i zhurmës së derës në hapje të butonave + llambat e kateve	Kontrollet periodike përfshijnë: • Kontrollin e mbylljes mekanike të dyerve të kabinës dhe sheshpushimit. • Verifikimin e kontaktit elektrik dhe funksionimit të çelësit të emergjencës. • Pastrimin e kasës së dyerve dhe karelit sipër dhe brenda. • Kontrollin dhe regjistrimin e hapësirës së ulave dhe gërvishtjeve. • Kontrollin për konsumim dhe shtrëngim të patinave dhe rulateve të akopjimit. • Provën funksionale të hapjes dhe mbylljes së dyerve.

		Kontrollin e zhurmës gjatë lëvizjes së dyerve dhe funksionimin e butonave + llampave të kateve.
10	Gjithnjë bëhet kontroll i funksionimit të impiantit, alarmit, llampës së emergjencës dhe manovrën me dorë.	Kontrollet periodike përfshijnë: • Verifikimin e funksionimit të plotë të impiantit të ashensorit. • Kontrollin e alarmit dhe llampës së emergjencës. Testimin e manovrës me dorë (manuale) për sigurimin e lëvizjes së kabinës në rast emergjence.
11	Funksionimin e alarmit pa tension, konsumin, zgjatjen, rrëshqitjen e kavove. Tokëzimin e ashensorit. Limitatorin e shpejtësisë. Kontroll i qarqeve të sigurisë dhe mbrojtjes. Distanca kat-kabinë (max 30 mm). Valvolën e rënies. Efikasitetin e termikut.	Kontrollet periodike përfshijnë: • Testimin e funksionimit të alarmit në mungesë tensioni (pa energji). • Kontrollin e konsumit, zgjatjes dhe rrëshqitjes së kavove. • Verifikimin e tokëzimit të ashensorit. • Kontrollin e limitatorit të shpejtësisë dhe pajisjeve për kufizim mbishpejtësie. • Kontrollin e qarqeve të sigurisë dhe mbrojtjes. • Matjen e distancës kat-kabinë (maksimum 30 mm). • Kontrollin dhe funksionimin e valvolës së rënies. Vlerësimin e efikasitetit të termikut (mbrojtjes termike).
12	F.v. vajnica dhe vaj per shinat	Depozita vaji per vetevaisjen e shinve dhe vaj
13	F.v. graso në nyjet lëvizëse	graso në nyjet lëvizëse
14	F.V. vaj hidraulik 46	Vaj Iso 46 per sisteme hidraulike
15	F.v. llampa 100 W per ndriçimin e pusit	llampa 100 W 220volt per ndriçimin e pusit
16	F.v. çelsa te dyreve te kateve	Çelsa per qarkun e sigurise te dyreve te kateve
17	F.v. çelsa avarie te kabines	Çelsa per qarkun e sigurise avarie te kabines
18	F.v. butona te thirrjes se kateve	butona te thirrjes se kateve nga jashte 12-24 VDC
19	F.V. Mekanizëm dere mekanike	Mekanizëm dere per dyert e jashtme 900mm-1300mm
20	F.v. rripa transmisioni të dyerve	rripa transmisioni të dyerve 5mmx12mm
21	F.v. llampa kabine per ndriçim 100wat	llampa kabine per ndriçim 100wat 220 volt
22	F.V. sensorë manjetik (no-nc)	sensorë manjetik (impulsore no-nc)
23	F.V. Guarnicion pistoni fi 100-200 mm	Guarnicion pistoni fi 100-200 mm
24	F.v. automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220 V, 63A	Automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220 V, 63A
25	F.v. automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P, Id=0,03A	Automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P, Id=0,03A
26	F.V. Rrëshkitëse kabine 8-16 mm	Rrëshkitëse kabine per shine 8-16 mm
27	Butona tregues te dyreve te jashtme	Butona tregues te dyreve te jashtme (Display - ekran)
28	Butoneri e brendeshme	Butoneri e brendeshme 1-6 kate
29	F.v kabëll fleksibël ashensori	kabëll fleksibël ashensori 24x075mm
30	F.v kavo çeliku fi 12 ashensoret	kavo çeliku fi 12 ashensoret
31	F.v. patina portash	patina portash (reshkitese te kanatave te dyerve)

32	F.v. rula për hapje dhe mbyllje dere	Rula për hapje dhe mbyllje dere (fermator-telco-geman)
33	Kuzhineta pulexhi hid	Kuzhineta pulexhi hid (pulexhi I pistonit)
34	F.v. inverter dyersh	inverter dyersh (fermator-telco-geman)
35	F.v. pult komandimi	pult komandimi (pult I cili perdoret per servisim-mirmbajtjen)
36	F.v. lëshues 63A	lëshues 63A 4p 24 -220 VDC
37	F.v. operator kabine	Operator kabine 800-1300 mm
38	F.v motor mekanik kabine (24V DC)	motor mekanik kabine (24V DC)
39	F.v. fotocelule (12 V DC)	fococelule (sesnsor dere 12 V DC)
40	F.v. akses karte	akses karte (cipa akses)
41	F.v kontaktet e dyerve te jashteme	kontaktet e dyerve te jashteme 48-110 AC
42	F.v Display	Display (ekran qe tregon numrat ne kabine 7 segmente)
43	F.v Panel kontrolli 22 kw hidrualik	Panel kontrolli 22 kw hidrualik 380 volt
44	F.v Emergjence e kompletuar per ashensor hidrualik	Emergjence e kompletuar per ashensor hidrualik
45	F.v bateri emergjence 12 v 7 a/h	bateri emergjence 12 v 7 a/h

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimet do të kryhen në mënyrë periodike, çdo muaj dhe detajimi i këtyre ndërhyrjeve do të përcaktohet më konkretisht në minikontratat që do të lidhen rast pas rasti sipas nevojave.

Operatori ekonomik kontraktues duhet të paraqitet pranë Spitalit Rajonal Korçë, jo më vonë se 30 minuta nga njoftimi i AK në rast avarie në ashensorët, duke qenë se institucioni ynë është institucion i një rëndësie të veçantë si shërbim spitalor.

Në rast se kërkohet të kryhet zëvendësim pjesësh sipas preventivit, Operatori Ekonomik kontraktues, duhet ta kryejë këtë zëvendësim jo më vonë se 24 orë nga njoftimi.

Në rast se nuk kërkohet të kryhet zëvendësim pjesësh, shërbimi duhet të kryhet jo më vonë se 2 orë nga njoftimi.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 2: SHËRBIM I MIRËMBAJTJES SË ASHENSORËVE TË SPITALIT RAJONAL VLORE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Të dhënat teknike të Ashensorëve, për të cilët do të realizohet shërbimi i mirëmbajtjes:

A. ASHENSORI I POLIKLINIKES

Marka-Dopler

Tipi MRL

Elktrike 1m/s

Peshëngritje 400 kg

Viti i prodhimit- 2015

B. ASHENSORI I SPITALIT (I RI)

Marka-Ahmet

Tipi MRL

Elktrike 1m/s

Peshengritje 1800 kg

Viti i prodhimit- 2021

C. ASHENSORI I SPITALIT (I VJETER)

Marka-Raver

Tipi MR

Elktrike 1m/s

Peshengritje 1800 kg

Viti i prodhimit- 2010

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimet për mirëmbajtjeje të ashensorëve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë, janë si më poshtë:

<u>Emërtesa</u>	<u>Njësia</u>
ASHENSOR I VJETER(SPITALI)	
Mirembajtje e sistemit levizes	herë
Mirembajtje e sistemeve elektronike te komandimit	herë
Mirembajtje e sistemeve elektronike te sinjalizimit	herë
Karta elektronike komandimi	cope
Nderrim bateri emergjence 12v7a	cope
Nderrim skede sistemit t emergjences	cope
Butona komandimi	cope
ndricim kollone	cope
ndricim kabine	cope
Nderrim te sensorve te dyerve	set
Nderrim leshuesi 16a	cope
Mekanizmat e gabines	cope
Portat e jashtme te kateve	cope
Plastiket levizese	cope
Mrojtese siper gabines	cope
Rregullatore I shpejtesise	cope
POLIKLINIKA	
Mirembajtje e sistemit levizes	herë
Mirembajtje e sistemeve elektronike te komandimit	herë
Mirembajtje e sistemeve elektronike te sinjalizimit	herë
Karta elektronike komandimi	cope
Nderrim baterie e emergjences 12v7a	cope

Nderrim te sensorve te dyerve	set
Nderrim leshuesi 16a	cope
ndricim kollone	cope
ndricim kabine	cope
ASHENSOR I RI (SPITALI)	
Mirembajtje e sistemit levizes	herë
Mirembajtje e sistemit te komandimit	herë
Mirembajtje e sistemit sinjalizimit	herë
Karta elektronike komandimi	cope
Nderrim I sensorve te dyerve	set
Nderrim bateri emergjence 12v7a	cope
paket cipi	cope

Në rastet kur njësia është “here”, shërbimi do të kryhet çdo 3 muaj. Dhe në rastet kur njësia është “cope”, shërbimi do të kryhet sa here të jetë e nevojshme.

Ofruesi i shërbimit merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese si dhe korrigjueset (riparuese) me njoftimin e Autoritetit Kontraktor.

Qellimi i shërbimeve: Siguria e Stafit dhe pacienteve ne menyre qe t’i ofrohet sherbim i panderprere.

Mirëmbajta duhet të përfshijë shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese, riparuese. Kjo marrëveshje kuadër/kontratë duhet të garantojë performancë të vazhdimësinë duke ofruar shërbim pa ndërprerje për pacientët dhe stafin mjekësorë, duke mundësuar shfrytëzimin eficient të këtyre pajisjeve.

Operatori ekonomik, i cili do të mirëmbajë ashensorët t’i përgjigjet thirrjes emergjente brenda 30 minutave.

Operatori ekonomik duhet t’i përgjigjet kërkeses se AK 24/7.

** Pajisjet/agregatet/materialët që do të përdoren për furnizim vendosje duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike/ose ekuivalente.*

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor
vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 1: RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE E ASHENSORËVE TË SPITALIT KORÇË

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Riparim dhe mirëmbajtje e ashensorëve të Spitalit
Korçë, sipas specifikimeve teknike

Nr	Emërtimi	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Kabina e ashensorit	Gabina dhe veshja e brëndshme e gabinës dhe kontrolli i përmasave. Pajisjet dhe kontrolli i mbylljes mekanike + elektrike të dyerve në sheshpushim dhe në gabinë. Kontroll i çelësave fundorë. Kontroll i pajisjes bllokuese të derës dhe çelësi i tij. Ndriçimi i kabinës. Ndriçimi emergjent. Mirëmbajtja e komponentëve të instalimit elektrik. Gjëndja e dyshemesë. Butonat dhe llampat e prenotimit. Butonat hapje+mbyllje porte. Çelësat e sigurisë.	Orë pune	50
2	Tavani i kabinës	Gjëndja e tavanit të kabinës. Kontroll, pastrim, regjistim operatori. Kontakti i parashutës. Vajisje e shinave të kabinës. Gominat e fiksimit kabinë-arkade. Kontroll tokëzimi kavo, kabinë arkade. Gjëndjen e fijeve flesibël.	Orë pune	50
3	Salla e makinerive	Pastrimi dhe ndriçimi i sallës. valvolës së rënies. Kontroll pajisjes për parandalimin e lëvizjes së pakontrolluar të kabinës gjatë lëvizjes. Kontroll i paisjes për sigurimin se ashensori nuk funksionon nëse dyert në sheshpushim janë të hapura. Kontroll pajisjeve për kufizimin e mbishpejtësisë. Kontroll kavot metalike dhe kavo tërheqëse. Kontroll funksionimit të automatëve. Kontroll i agregatit ngritës. Kontroll gjëndjes kavos së rregullatorit. Kontroll i kavove metalike	Orë pune	50
4	Arganello e ashensorit	Kontroll i nivelin e vajit në reduktor. Kontroll i ventilatorit ftohës .Pastrimi i elektromotor, reduktor . Kontroll për xhoko vidë-koronë, pastrimi i temburos së kontroll pulexhos	Orë pune	50

		el/motorit dhe devijimet , fortësisë së sustës së frenit. Kontroll gjëndjen e ferrotave të frenit.		
5	Kafazi i ashensorit	Pastrimi, shtrëngimi i stafave të shinave. Pastrimi, shtrëngimi i dyerve të katit. Kontroll i stafave të petashuqeve. Ndriçimi i kafazit. Tokëzimi i shinave udhëzuese.	Orë pune	50
6	Kuadri i manovrës	Kontroll zhurme lëshues, rele etj. Shtrëngim fije tek lëshuesit dhe relet . Provë + rregjistrim termikun e thithjes. Kontroll tokëzimit të kuadrit. Kontroll përqafimi i morsetave tek skeda. Pastrim skede, kontroll transformatori.	Orë pune	50
7	Arkaden	Kontroll dado tirante, morsetat e kavove .Kontroll morsetat e kavos së rregullatorit. Shtrëngimi i bulonave të arkaden. Kontroll xhoko (hapsire) guarnicioneve. Gjëndja e tirantit, prova e parashutës. Kontroll arkades, k/peshës dhe kavot. Vaisje shinave, kabinë+kundrapesha. Gjëndja fizike në tërësi	Orë pune	50
8	Gropa e ashensorit	Kontroll, pastrim i gropës. Kontroll i deviatorit dhe prizës. Kontroll i gjëndjes së sustës+zinxhirit. Kontroll distc. kabinë-k/peshësusta. Kontroll kontakti kavos së rregullatorit. Kontroll gjëndjes pulexhos tendikavos. Kontroll i zgjatjes së kavos rregullatorit. Kontroll bazamentit, korodimit shinave	Orë pune	50
9	Portat e kateve	Kontroll i mbylljes mekanike dyerve Kontakti elektrik, çelësi i emergjencës, pastrim i kasës sipër dhe i karelit Kontroll-rregjistrim i hapsirës ulave. Kontroll për konsumim, shtrëngim i patinave rulat e akopjimit. Provë Kontroll i zhurmës së derës në hapje butonave + llampat e kateve.	Orë pune	50
10	Të përgjithshme	Gjithnjë bëhet kontroll i funksionimit të impiantit, alarmit, llampës së emergjencës dhe manovrën me dorë.	Orë pune	50
11	Në çdo tre muaj bëhet këto verifikime dhe kontrole	Funksionimin e alarmit pa tension, konsumin, zgjatjen, rrëshqitjen e kavove. Tokëzimin e ashensorit. Limitatorin e shpejtësisë. Kontroll i qarqeve të sigurisë dhe mbrojtjes. Distanca kat-kabinë (max 30 mm). Valvolën e rënies. Efikasitetin e termikut.	Orë pune	50
12	F.v. vajnica dhe vaj per shinat		Litra	60
13	F.v. graso në nyjet lëvizëse		Kg	8
14	F.V. vaj hidraulik 46		Litra	400
15	F.v. llampa 100 W per ndriçimin e pusit		Copë	20
16	F.v. çelsa te dyreve te kateve		Copë	30
17	F.v. çelsa avarie te kabines		Copë	45

18	F.v. butona te thirrjes se kateve	Copë	30
19	F.V. Mekanizëm dere mekanike	Copë	8
20	F.v. rripa transmisioni të dyerve	Copë	15
21	F.v. llampa kabine per ndriçim 100wat	Copë	20
22	F.V. sensorë manjetik (no-nc)	Copë	25
23	F.V. Guarnicion pistoni fi 100-200 mm	Copë	4
24	F.v. automat termo/el.manj. Diferecial 2P, 220 V, 63A	Copë	5
25	F.v. automat magneto-termik 380 V, 25A, 4P, Id=0,03A	Copë	5
26	F.V. Rrëshkitëse kabine 8-16 mm	Copë	50
27	Butona tregues te dyerve te jashtme	Copë	30
28	Butoneri e brendeshme	Copë	3
29	F.v kabëll fleksibël ashensori	ml	150
30	F.v kavo çeliku fi 12 ashensoret	ml	200
31	F.v. patina portash	Copë	70
32	F.v. rula për hapje dhe mbyllje dere	Copë	80
33	Kuzhineta pulexhi hid	Copë	6
34	F.v. inverter dyersh	Copë	4
35	F.v. pult komandimi	Copë	2
36	F.v. lëshues 63A	Copë	20
37	F.v. operator kabine	Copë	2
38	F.v motor mekanik kabine (24V DC)	Copë	3
39	F.v.fotocelule (12 V DC)	Copë	8
40	F.v.akses karte	Copë	11
41	F.v kontaktet e dyerve te jashteme	Copë	30
42	F.v Display	Copë	8
43	F.v Panel kontrolli 22 kw hidrualik	Copë	2
44	F.v Emergjence e kompletuar per ashensor hidrualik	Copë	4
45	F.v bateri emergjence 12 v 7 a/h	Copë	30

Afatet e ekzekutimit:

Sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor dhe specifikimeve teknike, brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

LOTI 2: SHËRBIM I MIRËMBAJTJES SË ASHENSORËVE TË SPITALIT RAJONAL VLORE

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Shërbim i mirëmbajtjes së ashensorëve të Spitalit Rajonal Vlorë, sipas specifikimeve teknike

<u>Emërtesa</u>	<u>Njësia</u>	<u>Sasia</u>
ASHENSOR I VJETER(SPITALI)		
Mirembajtje e sistemit levizes	here	4
Mirembajtje e sistemeve elektronike te komandimit	here	4
Mirembajtje e sistemeve elektronike te sinjalizimit	here	4
Karta elektronike komandimi	cope	15
Nderrim bateri emergjence 12v7a	cope	4
Nderrim skede sistemit t emergjences	cope	1
Butona komandimi	cope	8
ndricim kollone	cope	1
ndricim kabine	cope	1
Nderrim te sensorve te dyerve	set	2
Nderrim leshuesi 16a	cope	6
Mekanizmat e gabines	cope	2
Portat e jashtme te kateve	cope	5
Plastiket levizese	cope	8
Mrojtese siper gabines	cope	1
Rregullatore I shpejtesise	cope	1
POLIKLINIKA		
Mirembajtje e sistemit levizes	here	4
Mirembajtje e sistemeve elektronike te komandimit	here	4
Mirembajtje e sistemeve elektronike te sinjalizimit	here	4
Karta elektronike komandimi	cope	15
Nderrim baterie e emergjences 12v7a	cope	6

Nderrim te sensorve te dyerve	set	1
Nderrim leshuesi 16a	cope	4
ndricim kollone	cope	1
ndricim kabine	cope	1
ASHENSOR I RI (SPITALI)		
Mirembajtje e sistemit levizes	here	4
Mirembajtje e sistemit te komandimit	here	4
Mirembajtje e sistemit sinjalizimit	here	4
Karta elektronike komandimi	cope	15
Nderrim I sensorve te dyerve	set	2
Nderrim bateri emergjence 12v7a	cope	4
paket cipi	cope	1

Afatet e ekzekutimit:

Sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor dhe specifikimeve teknike, brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Shtojca 8.

TERMAT E REFERENCES

LOTI 1: RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE E ASHENSORËVE TË SPITALIT KORÇË

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Riparim dhe mirëmbajtje e ashensorëve të Spitalit Korçë

Detyrat: Sipas Specifikimeve Teknike

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve Teknike

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë

Shtojca 8.

TERMAT E REFERENCËS

**LOTI 2: SHËRBIM I MIRËMBAJTJES SË ASHENSORËVE TË SPITALIT
RAJONAL VLORE**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Shërbim i mirëmbajtjes së ashensorëve të Spitalit Rajonal Vlorë, me qëllim sigurinë e Stafit dhe pacientëve, në mënyrë që t'i ofrohet shërbim i pandërprerë.

Detyrat: Sipas Specifikimeve Teknike

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve Teknike

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Spitali Rajonal Vlorë

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

LOTI 1: RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE E ASHENSORËVE TË SPITALIT KORÇË

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të

përfashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit.

